



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr.464-13205 të datës 31.03.2014, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

URDHËRESË
PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS PËR KOMPENSIMIN E PUNËS TË ANËTARËVE TË
KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

- I. **URDHËROHET**, Drejtorati për Buxhet dhe Financa që konform nenit 8 Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr.464-13205 të datës 31.03.2014 të bëj ekzekutimin e pagesës për kompensimin e punës të anëtarëve të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit për vitin 2016 konform procesverbalit.
- II. Paga për një ankand-konkurs do të jetë në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro)
- III. Urdhëresa hyn në fuqi menjëherë
- IV. Urdhëresa i dërgohet për zbatim Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400-68841
Lipjan, më 18.11.2016

